



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 95
Prishtinë, më 17.12.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Mungoi: Fatmir Xhelili.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dhurata Kryeziu-OSBE, Ramadan Islami-GIZ, Vlora Nushi-UNMIK/OPA, Venera Gashi-praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antingona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 06.12.2013;**
3. **Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për vitin 2013;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

Kryetari propozoi plotësimin e rendit të ditës, me shqyrtimin e informatës nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në pikën e tretë të rendit të ditës hyn shqyrtimi i informatës nga MPB-ja, ndërsa pika e tretë e rendit të ditës, kalon si pikë e katërt e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.12.2013

Goran Marinković- Bëri vërejtje në përkthimin në gjuhën serbe, pasi pjesa ku është përfolur diskutimi i tij në disa raste është i pa kuptueshëm.

Kryetari – Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 06.12.2013.

Procesverbali u miratua me vërejtje.

3. Shqyrtimi i informatës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kryetari- Informata e kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me pyetjet të cilat i janë bërë nga ana e Komisionit për çështjen e përfshirjes së pjesëtarëve të MUP-it në Policinë e Kosovës, është ardhur në Komision.

Interesimi i zbatimit të marrëveshjeve, ka qenë që në shtator të përfundoj ekzistimi i institucioneve ilegale në veri të Kosovës, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe është duke u bërë me vonesë.

Në mungesë të versionit në gjuhën serbe të informatës nga MPB-ja, dhe për nevojat e anëtarëve të Komisionit që të përkthehet në gjuhën serbe, citoi raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Tutje tha se si Komision duhet të kemi vlerësimin tonë dhe konsiderojmë se përkundër vonesave që kanë ndodhur, ka filluar ky proces në bazë të marrëveshjes së arritur. Gjithashtu konsideroj se Agjencia e Kosovës për Inteligjencë të angazhohet në mënyrë që të bëhet verifikimi i saktë i të gjithë pjesëtarëve që inkuadrohen në Policinë e Kosovës, duke marrë parasysh që nuk mund të jenë pjesë e Policisë së Kosovës, ata të cilët kanë kryer krime ose kanë vepruar në kundërshtim me ligjet e Kosovës duke cenuar interesin e qytetarëve të Kosovës.

Tutje hapi debatin për informatën e pranuar nga MPB-ja dhe ftoi anëtarët e Komisionit të marrin fjalën.

Rexhep Selimi- Ana e mirë e këtij raporti është që me gjithë problemet që ka ky proces, në këtë raport vihen në pah dhe nuk tentohet të fshihen ose nuk mund të fshihen më.

Vlerësimet e mija lidhur me raportin kanë të bëjnë me pikën e parë dhe të tjerat, duke u nisur me vlerësimet jo adekuate të palëve deri te pranimi i listës së ish pjesëtarëve të MUP-it nga autoritetet e Kosovës, gjë që nuk është dashur të jetë kështu dhe është dashur të kundërshtohet në vazhdimësi, por në realitet kjo gjë nuk është kundërshtuar, por është stimuluar gjatë procesit të negociatave.

Gjithashtu në tekstin e informatës, në disa raste i referohen duke i cilësuar si ish-pjesëtarë të MUP-it dhe në disa raste si pjesëtarët të MUP-it. Tutje një fjali e kësaj informate “përkundër faktit se nuk ka pasur një marrëveshje të shkruar”, ndërsa në paragrafin pasues të kësaj pike thuhet “Kemi të bëjmë me një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar”, pyetja është:

Si është marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar kur në të njëjtën kohë nuk është edhe marrëveshje e shkruar?

Në këtë rast Ministri i MPB-së, nuk duhet të ktheje në një zëdhënëse të negociatave, por do të duhej të raportonte në mënyrë më teknike dhe jo kaq politike, pasi si Komision kemi kërkuar informata për një proces i cili është shumë i ndjeshëm.

Ndërsa sa i përket pikës së katërt të këtij raporti, që ka të bëjë me shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrotja Civile”, duke u rikthyer në marrëveshjen pesëmbëdhjetë pikëshe, ku nga pika gjashtë deri të pika dhjetë ka të bëjë me sigurinë, dhe në këtë marrëveshje thuhet që të gjitha institucionet e sigurisë do të kenë vend të njëjtë në strukturat e sigurisë së Kosovës, duke mos e përmendur “Mbrotjen Civile”, pasi ne nuk kemi një mbrotje civile ku ata mund të transformoheshin.

Pra nuk pajtohem me përbërjen e tekstit dhe jo me raportimin në këtë rast, dhe shpreh kundërshtimin për këtë proces që po ndodh në dëm të sigurisë në vendit dhe jo të unifikimit të faktorit të sigurisë në Kosovë, duke shkuar në ndarjen etnike të sektorit të sigurisë, gjë që mund të jetë e rrezikshme për sigurinë.

Raportin e ministrisë e vlerësoj më shumë si politik se sa profesional dhe teknik, gjë që nuk do duhej të ishte kështu, por me keq se raporti është situata aktuale ku përfshirja e prestatëve të MUP-it në Policinë e Kosovës nuk po bëhet në rrugën e duhur, pasi bazuar në raportin e pranuar thuhet që nuk po bëhet shuarja e strukturave të MUP-it, por integrimi i tyre në Policinë e Kosovës dhe këtij procesi i mungon diçka shumë e domosdoshme, siç është verifikimi i sigurisë të pjesëtarëve që hyjnë në radhët e Policisë së Kosovës, pasi në rast se nuk bëhet ky verifikim për këta pjesëtarë, diskriminohen pjesëtarët e tjerë të policisë për të cilët është bërë verifikimi i sigurisë nga ana e AKI-së, gjë që rrezikon efikasitetin e kësaj policie.

Nuk është e mjaftueshme vetëm verifikimi që bëhet nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por para se të bëhej verifikimi nga ana e AKI-së, do duhej që ky proces të mos pranohej.

Anton Quni- Theksoi se me pranimin e informatës nga MPB-ja, është shuar kureshtja për anëtarët e Komisionit dhe për mediat, lidhur me teknikat se si do të integrohen ish-pjesëtarët e MUP-it në kuadër të Policisë së Kosovës.

Tutje shtoi se pajtohet me z. Rexhep Selimi që çdo pjesëtarë që do të bëhet pjesë e Policisë së Kosovës t'i bëhet verifikimi i sigurisë, gjë të cilën e ka kërkuar edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë që verifikimi i sigurisë për pjesëtarët e policisë të bëhet nga ana e AKI-së. Prandaj konsideroj që edhe për pjesëtarët e ish-MUP-it duhet të respektohet e njëjta procedurë, që edhe në të ardhmen t'i nënshtrohen këtij verifikimi.

Vlerësoj se si Komision kësaj çështje duhet t'i qëndrojmë afër edhe më tutje dhe në planin e punës për vitin 2014 të jetë me prioritet mbikëqyrja e këtij procesi të integritetit të ish-pjesëtarëve të MUP-it në institucionet sigurisë, gjithashtu të mbikëqyrret procesi i trajnimit dhe edukimit të këtyre pjesëtarëve dhe performanca e tyre në stacionet policore, dhe kjo do të mund të bëhej përmes vizitave, kërkuar e raporteve etj.

Gjithashtu të kemi një bashkëpunim me Komisionin për Mbikëqyrjen e AKI-së, në mënyrë që të kemi një pasqyrë reale, se sa do të ndikoj kjo situatë në përmirësimin e respektimit të rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës.

Goran Marinković- Deri tani kemi pasur procesin e bisedimeve për veriun e Kosovës dhe për të gjithë ne ka qenë me rëndësi që ajo pjesë e Kosovës të kyçet në shoqërinë e Kosovës dhe të jetë pjesë e Kosovës, pra të bëhet integriteti i veriut.

Prandaj mendoj që ky raport, të cilin e kemi pranuar sot është për ndryshime të mira, sepse edhe Policia e Kosovës që është në atë pjesë të Kosovës, që ka qenë paralele, duhet të jetë pjesë e kësaj shoqërie dhe mendoj që këta njerëz tani do të jenë faktorë stabilizimi për atë pjesë të Kosovës.

Po ashtu mendoj që tani integriteti i tyre është shumë me rëndësi, sepse kjo është edhe pjesë e bisedimeve në Bruksel dhe duhet të shohim se çka fitojmë dhe çka humbim dhe mendoj se në këtë rast me integritetin e këtyre personave që kanë qenë në strukturat paralele, Kosova më shumë fiton sesa humb.

Konsideroj se raporti nga MPB-ja është mjaft i mirë dhe mendoj që si Komision duhet të përkrahim në mënyrë që ajo pjesë të integrohet në këtë shoqëri dhe ata persona të jenë pjesë e policisë së Kosovës, ku do t'i kenë detyrat dhe përgjegjësitë e veta.

Ganimete Musliu- Vlerësoi si pozitive që është ofruar raport nga ana e MPB-së, i cili na bënë më të qartë se si kanë rrjedh procedurat për procesin e integritetit të pjesëtarëve të ish-MUP-it në institucionet e sigurisë së Kosovës. Mundësitë për të vepruar në veri të vendit janë këto që janë dhe është pozitive që ka filluar integriteti i ish -pjesëtarëve të MUP-it dhe ky proces bëhet në përputhje me legjislacionin e Kosovës që rregullon këtë fushë.

Pajtohem me z. Rexhep Selimi që për këta pjesëtarë duhet të bëhet verifikimi i sigurisë dhe vlerësoj se kjo informatë i heq dilemat për ne, si Komision, për këtë çështje dhe për mediat që kanë dashur të kenë informacion.

Konsideroj se si Komision duhet të jemi të gatshëm të mbështesim integritetin e pjesës veriore dhe të jemi të matur në deklaratat tona, pasi deri tani kemi vepruar në mënyrë profesionale dhe unik dhe të tillë duhet të vazhdojmë, për të ndihmuar procesin që ndodh në këtë pjesë.

Vjollca Krasniqi- Lidhur me informatën e pranuar nga MPB-ja tha se nuk i heq dilemat dhe dyshimet që procesi i integritetit të ish –pjesëtarëve të MUP-it do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Këto dilema do të hiqeshin gjatë procesit, pasi ky proces sapo ka filluar dhe janë vetëm njëzet pjesëtarë që kanë filluar trajnimin, ndërsa është një numër prej 250-270 që është paraparë të integrohen në institucionet e Kosovës.

Prandaj vlerësoj që si Komision duhet të jemi vigjilent që të përcillet ky proces me përpikëri, pasi dilemat nuk hiqen me këto përgjigjeje të raportit të MPB-së.

Ganimete Musliu- Nuk desha të them që hiqen dilemat për procesin, por është pozitive që kemi material të shkruar, si anëtarë të Komisionit dhe se deri tani çdo procedurë ka filluar konform legjislacionit të Kosovës.

Kryetari- Konstatoi se informata është sjellë me kohë sipas kërkesës dhe se kërkesat tona si Komision dalin sipas deklarimeve të anëtarëve të Komisionit.

1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë të bëjë verifikimin e sigurisë për të gjithë pjesëtarët të cilët hyjnë në kuadër të Policisë së Kosovës.
2. Të gjithë ata që kanë bërë vepra antiligjore, kanë cenuar jetën e qytetarëve dhe integritetin territorial duhet të mos jenë pjesë e Policisë së Kosovës.
3. Në planin e punës së Komisionit për vitin 2014, të jetë prioritet përcjellja në vazhdimësi e angazhimit të pjesëtarëve të MUP-it në Policinë e Kosovës, në mënyrë që të kemi pasqyrë më të qartë të këtij procesi.

Rexhep Selimi- Bëri vërejtje për pikën 2, duke e plotësuar atë se, përveç se këta pjesëtarë që kanë bërë vepra antiligjore nuk mund të jenë pjesëtarë të policisë së Kosovës, me rastë të tilla duhet të merren organet e drejtësisë, në mënyrë që këta pjesëtarë të marrin dënimin meritator.

4. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për vitin 2013

Kryetari- Theksoi se Komisioni gjatë vitit 2013 ka shqyrtuar dhe amandamentuar një numër të projektligjeve, ka bërë mbikëqyrjen e ligjeve, ka realizuar dëgjime publike, vizita në terren etj. Gjithashtu pjesë e punës kanë qenë edhe vizitat studimore jashtë vendit, si dhe tryezat e mbajtura brenda vendit, po ashtu Komisioni ka pritur delegacione nga jashtë, si dhe delegacione të shoqërisë civile.

Të gjitha aktivitetet e realizuara janë përmbledhur në raportin paraprak, i cili është vetëm një përmbledhje, ndërsa raporti përfundimtar do të plotësohet dhe do të miratohet në Komision në muajin janar 2014.

Rexhep Selimi- Vlerësoi se raporti paraprak ka nevojë për plotësime teknike dhe se Komisioni ka qenë në nivel në realizimin e planit të tij, ndërsa aktivitetet e pa realizuar mund të barten në planin e punës për vitin që vjen dhe ky plan mund të ishte për periudhën janar- korrik 2014.

Ganimete Musliu- Falënderoi stafin mbështetës të Komisionit, si dhe organizatat që mbështesin Komisionin.

Kryetari- Vlerësoi se plani i punës së Komisionit për vitin 2014, të behet për gjithë vitin, në mënyrë që të jetë vazhdimësi e punës për Komisionin e ardhshëm pasi në vitin që vjen jemi në vitin zgjedhor.

5. Të ndryshme

Dhurata Kryeziu, OSBE- Njoftoi se nga ana e OSBE-së është paraparë një drekë punë për të vlerësuar realizimin e planit të punës për vitin 2013 nga ana e Komisionit, ndërsa në vitin që vjen është paraparë një punëtori për të mbështetur përgatitjen e planit të punës për vitin 2014, duke u bazuar në agjendën legislative për vitin vijues.

Kryetari- Në mbyllje falënderoi anëtarët e Komisionit për angazhimin e tyre, organizata që mbështesin Komisionin, si dhe administratën.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi